



**Gazetën do ta gjeni në internet në formatin PDF në adresën:
www.shoqatastebleva.com, në kuadratin gazeta, numri i fundit**

STEBLEVA



GAZETË E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nr.24. Prill 2012.

Çmimi 70 lekë.

TË NXJERRIM MËSIMI NGA DIMRI I KALUAR DHE TË PËRGATITEMI PËR PRITJEN E TURISTËVE TË VERËS

EDITORIAL

TË NXJERRIM MËSIMI NGA DIMRI I KALUAR DHE TË PËRGATITEMI PËR PRITJEN E TURISTËVE TË VERËS

Në Steblevë edhe tani në prill ka gjysmë metër dëborë. Dimri akoma nuk ka kaluar, megjithse festuam ditën e verës dhe të Sulltan Nevruzit. Akoma nuk kanë çelur lulet. Dëbora këtë vit qe si asnjëherë tjetër. Ajo kalonte dy metrat. Vendi u izolua plotësisht. U bë përpjekje e madhe nga Kryetari i komunës Alban Fejza dhe nga ndërmarrja rajonale e rrugëve për hapjen e saj deri në Steblevë, që të bëhej e mundur shpëtimi i jetëve të njerëzve të sëmurë dhe në nevojë. Dimër të tillë nuk ishte parë prej dekadash, megjithse steblevasit përgatiten për dimër. Ata për kollaj dimri nuk i gjen në befasi. Por dimra të tillë të paparë ndonjëherë të bllokojnë. Ndaj masat e marra duhet të jenë edhe më të forta. Pushteti vendor nuk ka fonde për raste të tilla. Subjektet private janë të pafuqishme për të përbaluar raste të tilla. Tregëtarët e vegjël nuk e përballojnë furnizimin e gjatë në raste dimri. Njerëz të varfër nuk mund të blejnë rezerva të mëdha ushqimore. Edhe rezerva të mëdha për bagëtitë nuk mund të sigurohen. Kryetari A. Fejza kërkoi ndihma nga shoqata dhe individë të fuqishëm, nga pushteti qendror, nga Drejtoria e emergjencave. Helikopterë erdhën në raste urgjencash. Kryetari i Shoqatës "Stebleva" Mersin Hoxha ishte në Steblevë dhe Fushë Studën për dërgimin e ndihmave ushqimore dhe mjeksore atje. Erdhën ndihma nga Ambasada Franceze, nga shoqata të ndryshme, por të gjitha këto nuk mjaftojnë. Pushteti vendor ka nevojë për një autonomi më të madhe, për mbështetje financiare, për objekte shëndetsore dhe kuadër mjeksor. Ky dimër na bën të hedhim më mirë sytë nga pushteti vendor, nga fshati. Që tani të mendojmë për verën turistike, për pritjen e turistëve, të cilët janë informuar ndërmjet internetit dhe shtypit dhe kanë dëshirë që t'i shijojnë bukuritë e Steblevës.



Në këtë foto të rrallë të vitit 1970 gjeni veten dhe të afërmit tuaj

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Redaksia e gazetës "Stebleva" fton të gjithë bashkëpunëtorët e shtypit, intelektualët dhe qytetarët e thjeshtë steblevas të kontribuojnë me bashkëpunimet e tyre për të pasqyruar bukurinë e natyrës së Steblevës, historinë e saj të lavdishme dhe njerëzit e saj të mrekullueshëm.

Shkrimet nuk kthehen më nga redaksia. Mundësisht ato të dërgohen në e-mail sakip.cami@yahoo.com dhe me CD. Në pamundësi pranohen edhe me dorëshkrim.

LAJMËRIM

Njoftohen dhe janë të ftuar të marrin pjesë anëtarët e Shoqatës "Stebleva", historianë, shkrimtarë, gazetarë të të gjitha trevave të kombit shqiptar me datën 14 prill 2012 ora 11.00 në sallën e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë ku do të zhvillohet promovimi i librit të studiuesit Vahid Kormaku "Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritën e realitetit".

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI

VEPRIMTARI TË SHOQATËS. TAKIM ME AMBASADORIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
FAQE 2

AMBASADA FRANCEZE SHPËRNDAN NDIHMA PËR TË IZOLUARIT NGA DËBORA NË KOMUNËN E STEBLEVËS
FAQE 2

MEDIN KORMAKU, VEPRIMTAR I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT
FAQE 4

ADEM KORMAKU: Si e ndërtoam pesëmbëdhjetëkatëshin e parë në Shqipëri dhe monumentin e Mat'hauzenit në Austri
FAQE 5

Vahid Kormaku: Një ikonë e arsimit shqiptar

Nga Mehmet Hasani
FAQE 6

Ç'PONADJEG MALLI, O PERPARIM PIRUSHI!
FAQE 8

MJESHTRI I NDËRTIMIT XHA FER ÇELA, (Homazh pas vdekjes)
FAQE 4

SKULPTORI HAMZA HALILI. Artisti që e bën gurin dhe drurin të buzëqeshë dhe të qajë si njerëzit
FAQE 7

 **SHOQATA STEBLEVA**
Mersin HOXHA
Kryetar
Rr. "Xhon Belushi" Vila 519, prapa Fizikës Bërthamore Tiranë
Cel. 0695168173 / 0692065091
E mail: mersin_hoxha@yahoo.com
Web: www.shoqatastebleva.com



REDAKSIA E GAZETËS "STEBLEVA".

Drejtor: Mersin Hoxha/ Kryeredaktor: Sakip Cami, Vilma Disha, Eltana Nura redaktore.
Klikoni: www.shoqatastebleva.com; gazeta "Stebleva"

VEPRIMTARI TË SHOQATËS

TAKIM ME AMBASADORIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Hapja e pikës doganore kufitare të Steblevës, në vendin e quajtur piramida 30 ishte qëllimi kryesor i këtij takimi

Një grup nga Stebleva, i përbërë nga kryetari i komunës, Alban Fejza, kryetari i Shoqatës "Stebleva" Mersin Hoxha, kineasti Esat Musliu dhe veprimtari Xhelal Kurti u takuan kohët e fundit me Ambasadorin e Republikës së Maqedonisë në Tiranë, Z. Vele Trpevski. Qëllimi i këtij takimi, ndër të tjera ishte hapja e pikës doganore kufitare të Steblevës, në vendin e quajtur piramida 30.

Takimi ishte shumë miqësor dhe konstruktiv. Ambasadori Trpevski, nga ana e tij u angazhua që do të kontaktohej me përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme dhe të Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë për të për-

gatitur modalitetet e nevojshme në një kohë sa më të shkurtër të mundshme. Hapja e kësaj pike kufitare do të lehtësojë akoma më shumë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave në këtë zonë dhe do të forcojë ekonominë dhe lidhjen e mirë midis shtetasve të të dy vendeve tona fqinje.



TAKIM ME PËRFAQËSUES TË KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE SHQIPTARE

Kryetari i Shoqatës "Stebleva" Mersin Hoxha dhe një grup veprimtarësh të kësaj shoqate organizoi këto ditë një takim pune me përfaqësues të lartë të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Qëllimi i këtij takimi ishte sensibilimi dhe nxitja e Kishës Ortodokse Autoqefale për ndërtimin e një kisha ortodokse për komunitetin ortodoks në Steblevë, si dhe për res-

taurimin dhe ngritjen e të gjitha objekteve të shenjta të ortodoksizmit në këtë zonë. Përfaqësuesit e lartë të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare në Tiranë, u zotuan se fill pas përfundimit dhe përrurimit të Kishës së Madhe të Tiranës e gjithë puna dhe financimet do të përqëndrohen për ndërtimin e kishës së Steblevës dhe për ringritjen e vendeve të shenjta të Steblevës.

KRONIKA PA KOMENT NGA SHTYPI DHE TELEVISIONI

DËBORA E MADHE E SHKURTIT 2012

Stebleva nën 1.5 metra dëborë (Kronikë nga Televizioni Vizion Plus)



Ne shoqërinë e 1.5 metrave dëborë banoret e komunës Stebleve, janë izoluar prej javësh. Ne Librazhd fshatrat e kësaj komune janë me te prekur nga situata e vështirë që ka përfshirë vendin. Banoreve u kane mbaruar tashme rezervat e ushqimeve dhe ilaçeve.

Drejtimesit e komunës pohojnë, se kane vështirësi edhe ne transportin e te sëmurëve për ne Tirane. Drejtimesit e shëndetit publik te Elbasanit kane zëvendësuar stafin mjekësor te kësaj komune, me personel vendas, për ti paraprire çdo situatë

emergjente. Por ne gjendje te vështirë janë edhe komunat e Orenjes, Qukesit, Lunikut dhe Rrajces ku kryekomunaret thonë se nuk ka mbërritur asnjë ndihme nga shteti. Situata e vështirë është pranuar edhe nga prefekti i qarkut te Elbasanit. Një dite me pare i dërguari i qeverise për zonat juglindore Arben Imami ka kërkuar angazhimin e komunitetit për përballimin e situatave emergjente. Sipas pushtetit vendor problem mbetet furnizimi me nafte e mjeteve te renda qe merren me zhblokimin e rrugëve.

AKTIV I SHOQATËS "STEBLEVA" PËR ANALIZËN E PUNËS SË VITIT 2011

Kohët e fundit u mbledh aktivi i shoqatës "Stebleva". Aktivi diskutoi rreth veprimtarisë së shoqatës gjatë vitit 2011. Në takim mori pjesë edhe kryetari i komunës së Steblevës Alban Fejza. Fjalën kryesore e mbajti kryetari i shoqatës Mersin Hoxha, i cili vuri në dukje rolin gjithmonë në rritje të shoqatës në dobi të komunitetit, ngritjen e zërit të saj për mbrojtjen e pasurive natyrore, ujore dhe pyjore të fshatit dhe të komunës. Një rol të rëndësishëm në ngritjen e problemeve dhe në edukimin patriotik të brezave të këtij komuniteti ka dhënë edhe gazeta "Stebleva" si dhe faja e internetit të shoqatës www.shoqatastebleva.com.

Të pranishmit që e morën fjalën në aktiv theksuan rolin e shoqatës gjatë zgjedhjeve lokale, për të zgjedhur një njeri të mirë dhe të përgatitur nga Stebleva dhe jo siç ka ndodhur deri më tani që njerëz me-

diokër dhe pa integritet kanë drejtuar komunën tonë. Stebleva ka nxjerrë ndër kohëra burra të shquar dhe të mençur, prandaj të ecet në gjurmët e tyre dhe të propogandohen fort traditat patriotike të zonës. U theksua gjithashtu dalja në dritën e botimit e librit të parë "Stebleva, natyrë e virgjër, njerëz të mrekullueshëm, histori e përgjakur" dhe u bë thirrje biznesmenëve që vazhdojnë sponsorizimin e mëtejshëm të gazetës dhe të librave të tjerë për Steblevën.

Theksi duhet të vihet tek zhvillimi turistik dhe ndërtimet e reja në Steblevë, theksuan diskutantët, e shoqëruar kjo me zhvillimet strukturore dhe kulturore. Çështja e tokës, pronave, pyjeve, ujërave dhe kullotave, kthimi i tyre tek pronarët e vërtetë do të jetë edhe në të ardhmen objektivi kryesor i shoqatës.

Koresp. "Stebleva"

AMBASADA FRANCEZE SHPËRNDAN NDIHMA PËR TË IZOLUARIT NGA DËBORA NË KOMUNËN E STEBLEVËS

Komuniteti i Steblevës falenderon Ambasadën e Republikës së Francës në Tiranë dhe ambasadorin Christine MORO për ndihmat që shpërndau në zonën e Steblevës, një nga zonat më të izoluar nga dëbora e madhe që kalonte 2 metrat. Një kamion me ushqime, ilaçe, detergjentë etj nën kujdesin e vetë ambasadores Moro u erdhi

në ndihmë banorëve të kësaj zone të goditur nga kjo fatkeqësi natyrore. Komuniteti i kësaj zone vlerëson gjeshtin e lartë human dhe ndihmën konkrete të Ambasadës, Franceze, të Qeverisë Franceze, të popullit mik francez që jetoj me hallet dhe shqetësimet tona në ditët e dimrit të ashpër të shkurtit që kaloi.

GAZETA "TELEGRAF"

Stebleva, komuna më e izoluar e Librazhdit

Era ÇELA

REPORTAZH/

Mungojnë ushqimet, ilaçet dhe mjeku.

E pamundur ndërhyrja me helikopter për shkak të motit të keq

Stebleva shtrihet në aksin rrugor Librazhd - Dibër dhe ndodhet rreth 23 kilometra larg Librazhdit. Është ndër komunat më të largëta të këtij rrethi dhe ndodhet 1200 metra mbi nivelin e detit. Përbëhet nga disa fshatra si Studën, Sebisht, Stebleve, Moglicë, Borovë etj.. Sapo kalon Lunikun dëbora sa vjen e vështirësohet, në hyrje të fshatit Studën, ku është dhe qendra e komunës trashësia e dëborës i kalon 1 metër.

Banorët prej 1 jave ndjenë të ftohtin dhe mungesën e energjisë elektrike. Traktorët e Mirëmbajtjes së Rrugëve vazhdojnë të hapin rrugët pa ndërprerje, por ato bllokohen sërisht për shkak të reshjeve të dëborës. Moti i keq, era dhe suferina nuk lejojnë hapjen e saj dhe qarkullimin normal të banorëve të fshatrave, të paktën deri në qendrën e komunës. Thirrjet e banorëve për tu pajisur me ushqime u morën në konsideratë, por ulja e helikopterit në këtë zonë ishte e pamundur. Sipas Kryetarit të Komunës, Alban Fejza gjendja është e vështirë dhe moti nuk lejon asnjë për të ndërhyrë. "Situata është emergjente. Madje, nuk punojnë as telefonat dhe ka mungesë të energjisë elektrike. Problem mbetet dhe mungesa e


mjekut. Prej vitesh kjo komunë ka pasur probleme, sidomos infermierët mungojnë në këtë zonë. Vetëm rrogën marrin dhe nuk dihet nga janë", - tha Fejza. Mjeku Shyqyri Zogolli thotë: "Unë kam mbí 10 vjet që punoj me këta banorë, jam lidhur me ta dhe ua di hallet. Komuna e Steblevës është një nga komunat më të thella, shtëpitë janë shumë larg njëra-tjetrës dhe banorët kanë nevojë për mjek, prandaj duhet gjetur një zgjidhje urgjente". Prodhimet e fermerëve (që është patatja) për këtë vit kanë mbetur të bllokuara. Sipas kryetarit të Komunës, Alban Fejza, hapja e rrugëve është problem, fondet që janë përcaktuar nuk mjaftojnë sepse është një zonë e vështirë dhe që gjatë gjithë periudhës së dimrit mbetet e bllokuar.

Dashamir Boriçi, një banor i Steblevës shprehet: "Ne po jetojmë në kushte të vështira, jemi të bllokuar nga dimri i ashpër që po mban këtë vit. Problem kemi mjekun e zonës". Hysen Lami, 60 vjeç, nga Sebishti thotë: "Jemi fshati më i largët, por që kemi nevojë për më shumë ndihma. Dëbora i kalon dy metrat dhe energjia elektrike mungon, qeveria duhet të kujtohet edhe për ne". Sipas drejtorit të spitalit të Librazhdit, Veiz Boja thuhet se, spitali do të vendosi në dispozicion mjekë dhe infermier për komunitetin e Steblevës dhe më gjerë për komunën tjetër, "madje kemi krijuar dhe kushtet për dhoma rezervë në rast të ndonjë komplikacioni apo nevojë emergjente", tha Boja.



Stebleva, një perlë natyrore si në verë ashtu edhe në dimër*

Nga Iljaz Tamizi



Cilido që ka kaluar në anët tona, në Steblevë, ka mbetur i mahnitur nga bukuritë natyrore të tyre. Një pejsazh i pafund bukurish, pyje, bjeshkë, livadhe, burime ujore, që grupohen në tre drejtime që e përshkruajnë mes për mes fshatin me emërtimet e tyre interesante si Zalli i Bardhë, Zalli i Zi, Përroi i Thatë, etj. Kush nuk do të mahnitej nga bukuria dhe shija e peshqve të Zallit të Bardhë, njëllonj si korani i Liqenit të Pogradecit.

Pesë-gjashtë vitet e fundit në Steblevë ka patur frekuentim të madh dhe vazhdimisht në rritje të vizitorëve vendas dhe të huaj. Nuk mund të rrish pa u ngjitur gjatë verës në Visharicë dhe në Kallkan, pranë ujërave të tyre dhe të shijosh një qingj të pjekur në hell, nuk mund ti kundërshtosh propozimit të fëmijëve për të shkuar në Malin e Raduçit sepse në ato bjeshkë të shtohet jeta.

Këto bjeshkë në shekuj kanë qenë jeta jonë, streha

jonë dhe e bagëtive tona. Korra e barit shëndrrohej në festë të madhe dhe të organizuar. Asnjë nuk trembej nga lodhja e madhe dhe rruga e gjatë deri në majë të malit. Vërzomat e barit ngarkuar në kuajt tanë janë një veçanti për të gjithë krahinën. Në bjeshkë mbledhen të tre lagjet e Steblevës, të rinjë të reja burra e gra. Tek Prroi i Govatave grumbulloheshin dyqind kuaj dhe mbi to dyqind burra që kalëronin a thua se ishin në gara kuajsh dhe jo në festën e korjes së barit në bjeshkë. Këto bjeshkë janë legjendare. Aty është Varri i Nuses, ose Varri i Maries siç njihet ndryshe, në kufi me fshatin Llabunisht të Maqedonisë. Nga Varri i Nuses vazhdohej tek Kodra e Tamizit dhe Kodra e Krushqve. Sipas legjendës këtu në këto bjeshkë ngriu nga të ftohtit nusja që vinte nga Struga.

Sipas regjistrit të Vilajetit të Dibrës, në defterin turk, Stebleva ka patur 400 familje, 400 kuaj dhe 4500 kokë bagëti të imta. Ishte zonë e preferuar nga Turqia sepse merrej shumë haraç (taksa) prej saj.

Steblevasi t'kanë qenë shumë të lidhur me tokën e tyre, me këtë pasuri të rrallë që u kishte falur Zoti dhe Natyra. Ata kanë bërë shumë luftëra për ti mbrojtur ato. Unë nuk do të ndalem në historikun e plotë të saj sepse na e kanë lënë të plotë Vahid Kormaku, Adem Bojaxhiu, Islam Hoxha etj, por desha të vë në dukje se sot këto bukuri marrin edhe më shumë vlera me afrimin e Steblevës me Tiranën dhe asfaltimin e rrugës Librazhd-Steblevë.



Ndërtimi i Sharrave në Steblevë që një front dhe ndihmesë e madhe për steblevasit, por pas vitit 1990 sharrat u shkëtruan dhe njerzit filluan të largohen për në qytetet e Shqipërisë dhe jashtë shtetit. Tani ata po kthehen, po ndërtojnë shtëpi të reja, po ngrenë pemtore dhe ape shërbejnë më ape tokës. Pa dyshim ape est ë madh ka ngjallur turizmi, për vetë bukuritë mahnitëse të natyrës së saj. I pari ishte Astrit Bushati që ndërtoi një kompleks vilash turistike bashkëkohore. Zylf Avda ka ndërtuar një kompleks blegtoral, stalla, baxho, shtëpi banimi etj.

Ka mbarështruar mbi 200 kokë dele. Bulmeti i tij, djathi kaçkavall, gjalpi është shumë i kërkuar, bulmet 100% bio. Abib Kormaku ka ngritur një pemtore me 1000 rrënjë pemë frutore dhe me arrore pemë tjera që rriten në këtë ape. Blegtorë të tjerë të ape në këtë fshat janë Medi Kurti, Bardhyl Koburi, Zaim Kita etj. Kanë ndërtuar shtëpi të reja Emrulla Hoxha, Fatos Hoxha, Baki Nura etj.

Një shtytje të madhe i ka dhënë punës sonë në Steblevë stafi i ape komunës së Steblevës si dhe vizita e kryeministrit Berisha që inspektoi rrugën Librazhd-Steblevë. Për-

fundimi i kësaj rruge në vitin që vjen do të jetë një ndihmesë e madhe për zhvillimin ekonomik dhe të turizmit në zonën ape.

Rritja e kompetencave të pushtetit vendor për administrimin e territorit besoj se do ti ape fund zvarritjeve të deritanishme për kalimin e pyjeve dhe kullotave të Steblevës në administrim të komunës dhe të komunitetit, për t'i shijuar këto bukuri, këto mrekulli të natyrës sonë, për të zhvilluar më tej ato.

*** Ky shkrim është ribotuar me kërkesë të shumë banorëve steblevas**

Stebleva

Po tu besojmë gojëdhanave popullore Katundi Steblevë ka qënë quejtun Orvenik. Emni i sotëm Steblevë thuhet se ka mbet prej kohës së Turqisë, kur spahijt e Dibrës nuk mujten me e blemë të dhjetën e këtij katundi, prandaj u quejt Stebleva (nuk të bleva). Në pyjet e Steblevës dhe sot gjinden rrënojat e mashnave të dikurshme.

Në vitin 1467 Stebleva kishte 13 shtëpi me 90 banor të krishter me këta kryefamiljar: Kojo Porteviri, Martin i Petres, Miho Pishaja, Petko Gjoka, Gjon Mathinovi, Bogiç Mathinovi, Devasil Bogiçi, Nikolla Bogiçi, Bogdo Jerakari, Kolë Vlladin, Staneci, Simko Çermenika, Vasko Gjonko. Këta kryefamiljar, këta steblevasi i paguanin Turqisë taksa si: ispenxhi 335 akçe (njësi monetare turke), grurë kil (1kil = 30 okë) 5 x 20 = 100, thekër kil 2x14=28, tërshër dhe ergjër kil 14 x 10 = 140, thjërza kil ¼ x 32 = 8, taksa e mullirit 15 akçe, li 45, mjaltë 20 taksa e arusit dhe e nijabetit 110. Të ardhurat e përgjithshme 776.44)

Malet e Jablanicës steblevasit i quajn malet e Skënderbeut. Në kohë të hershme steblevasit, me prodhimet e tyre luenin (ndryshonin) çmimin e drithrave në pazarin e qytetit të Dibrës së Madhe.

Në këta 32 vitet e fundit (1912-1944) Stebleva asht damtue randë, 3 herë është djegur nga pushtuesit e huaj serbe. Gjaja e gjallë asht grabitun, shtëpitë i janë djegun. Steblevasit kanë qënë të shtërnguem të lanë vatrat e tyne dhe të marrin udhën e mërgimit për të sigurue jetesën familjare.

Patriotët steblevas të udhëhequr nga Hazis Lila, Islam Lama, Adem Bojaxhiu, Ahmet Gaxha, etj. udhëhoqën e luftuan si burra, si steblevas, si shqiptar kundër ushtrive serbe në mbrojtje të trojeve tyne, në kryengritjen e vitit 1920. Aktit atdhetar të steblevasve ushtria serbe iu përgjigj me djegien e fshatit dhe dëbimin e banorve nga vatrat e tyne.45) Steblevasve nuk u vinte keq për rrëmbimin e pasunisë nga vjedhjet e ushtrisë serbe, por dëshira për të jetuar të lirë në trojet e tyne.

Në vitin 1922 steblevasit u kthyen në trojet e tyne dhe nisën rihatas me ndërtue shtëpitë e djeguna nga ushtria serbe në korrik të 1920.

Vahid Kormaku, Steblevë, 1946

Jablanica e Drinkollit të Dibrës-Albanopolisi i motshëm i Shqipnis

Ka Shumë mundësi, që Jablanica e sotme të jetë Albanopolisi antik, ku banonte fisi ilir Alban, që përmend Klaud Ptolemeu.

Fjala "Alban" asht shumë e thjeshtë të kthehet në fjalën Jablanicë. Dihet se prapshtimi i fundit "C"-ja vjenë nga sllavishtja. Gjithashtu germa e parë e fjalës Jablanicë, pra "J" asht një shtesë dialektore përpara germës "a". P.sh në Jablanicë ose në Drinkoll po të pyesish njeri në ç'mulli e blove drithin, të përgjigjet: "vo jaleksandrova, vo". Kështu dhe në Elbasan e Mokër në vend që të thuhet Allah (Zot) thuhet Jalla. Haj ta ngremë këtë - Jalla, o burra" etj. Por dhe kanga popullore "Veson vesa në tokë t'Arbënisë (Shqipnis)" (Rosi rosa v'Albanska zemja), që këndohet prej grave të Drinkollit dhe të disa katundeve të Gollobordës, mund të ketë lidhje me fisin ilir Alban.

Jablanica gjindet në pjesën e Jugosllavisë (sot Maqedonisë - M.M.), afro 2 orë larg kufinit shqiptar. Vendi ku pohohet se ka qënë qyteti Albanopolisi asht një kodër në formë të zgjatur me një sheshore në majë. Sipër dheut të fortesë asht e mbulueme me lisa dushku; nga ana e portës duken disa grumbuj gurësh. Sheshorja asht e rrethueme me mure të forta. Nga të gjitha anët ka shesh pamje.

Në këtë vend gjinden rrënimet e dy fortesave: "Kala e

Jablanicës" apo "Skënderbegova Kala" dhe tjetra "Na Kala" dhe gjindet sipër katundit Jablanicë, rranzë malit Raduç.

Jablanicasit merreshin me bujqësi dhe blegtori. Gojëdhana thotë se banorët e vjetër të Jablanicës ushqeheshin me peta gruni të pjekuna në çerep. Në ndihmë të kësaj na vjenë një gjetje interesante. Buzë një shkambi në malin e Jablanicës, asht gjetun një sofër e vjetër 4 m nën tokë dhe çerep me trashësi 5 mm të shpuar në tri vende. "Këto bira, - thonë pleqtë, - shërbenin për të nxjerrë çerepet nga zjarrmi me anë të një hekuri a teli. Nga sa u tha duket se Petromaku i Jablanicës rrjedh nga fjalët petë e rumbullakët. Të gjitha këta duan të thonë se Jablanicasit janë pasardhësit e albanve dhe kalaja e Jablanicës asht qyteti Albanopolisi që na afron historiani Aleksandrin, Klaud Ptolemeu.⁴⁶⁾

Fakti që në Jablanicë mund të lokalizohet Albanopolisi e tregon vet emni: Albanopolisi, me të cilën siç duket quheshin dhe vet banorët e vendit. Siç shihet nga ky emën (Jablanicë) dhe vet banorët vendas, ilir quheshin alban. Sipas gojëdhanave e shenjave të ndryshme shifet se dhe Jablanica duhet të ketë qenë përfshirë në lufrat iliro-romake. Duket se ma vonë emëni etnik i albanëve u quejt Arbëni. Ky ndryshim duket se rrjedh nga shkëmbimi i germës "r" në vend të ger-

mës "l" me gjasë dialektore.

Nga emëni Jablanicë kup-tohet se ilirët e fisit Alban dhe vet quheshin me këtë emën e jo Arbëni. Që kur nisi të përhapej katolicizmi në Shqipni banorët e Arbënisë dhe të Kandavusë (Mokra e sotme) qenë nga të parat që u konvertuan në atë besim.

Prandaj kemi arsye të pohojmë se Drinkollit e Golloborda janë dy krahina albane që madje u quejtën Arbëni. Pra për lokalizimin e Albanopolisit nuk duhet mbështetur vetëm në të dhënat që na afron Drinkollit, por dhe Golloborda, banorët e së cilës rruajtë ma tepër nga cilësitet e traditave ilire në krahasim me Drinkollasit, për arsye se se këta të fundit kanë jetue krishterimin nën pushtetin e gjatë turk.

Lokalizimi i Albanopolisit në Jablanicë do të bëjë që viseve tona t'i shtohet dhe një emën, që asht kryefilli i të gjithave. Vetëm kur të dalin në dritë thesarët e nëntokës së Jablanicës mund të arrihet në një përfundim shkencor. Në kohë të Turqisë në Jablanicë u zbulue një mineral i çmueshëm. Arzo nga Jablanica, aso kohe, mori një shpërblim të mirë nga qeveria turke. Në vitet 1930-1941 edhe arkeologët serb kanë bamun punime intensive në Jablanicë.

Vahid Kormaku, Klenjë, 1944

MEDIN KORMAKU, VEPRIMTAR I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 10 qershor 1878, edhe Stebleva krijoi nëndegën e saj të Lidhjes, që varej nga Dega e Dibrës. Për ngritjen e nëndegës së Gollobordës me qendër në Steblevë në ka punuar patrioti steblevas Medin Kormaku. Njihet veprimtaria patriotike e kësaj nëndege dhe e këtij burri të shquar për ngritjen e forcave vullnetare për vetëmbrojtje, për sigurimin e armëve dhe të ndihmave financiare për forcat armatosura të Lidhjes.

Medin Kormaku, veprimtaria e të cilit kulmoi në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-881, është lindur në Steblevë më 1830, në familjen me tradita të Kormakajve.

Kulla e Kormakajve, e ngritur në dy kate me gurë të gdhendur Kojashume është dëshmitare e përpjekjeve të trimave të Steblevës për organizimin e rezistencës së kaësaj treve ndaj pushtuesve osmanë. Në këtë kullë, pas kthimit nga Turqia, ku u njoh me rilindas të shquar shqiptar, Medin Kormaku, sipas porosive të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, formoi nëndegën e Gollobordës dhe organizoi vetëmbrojtjen e saj. Ai kishte njohje dhe lidhje me Iljaz Pashë Dibrën, Abdyl Frashërin, Hoxhë Hasan Moglicën dhe me parinë e Di-

brës që luftonin për pavarësinë e Shqipërisë nga Turqia.

Medin Kormaku së bashku me mikun e tij nga Moglica që ishte shkolluar në Turqia me Hoxhë Hasan Moglicën morën pjesë në të dy kuvendet e Dibrës, të zhvilluara fill pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 1 tetor 1878 dhe me 20 tetor 1880, kuvende ku u diskutuan kërkesat për autonomi të zgjeruar të Shqipërisë etnike nga Turqia, e cila do të realizohej me kryengritjet popullore që kishin nisur.

Kormaku qëndroi në krye të kësaj rezistence deri sa vdiq në vitin 1894.

Pas Kongresit të Berlinit, Shqipëria u vu në rrezik jo vetëm nga Perandoria Osmane, por edhe nga fqinjët grabitqarë, që kishin bërë plane për ta copëtuar. Prandaj përpjekjet e patriotëve dhe luftëtarëve shqiptarë në këtë kohë u intensifikuan si për përpilimin dhe hartimin e alfabetit të gjuhës shqipe, e më pas përhapjen e shkollave shqipe, ashtu edhe për ngritjen me armë në dorë të popullit nga Jugu në Veri kundër pushtuesve turq.

Dhe pikërisht në këtë kohë kemi daljen në skenë të dhjetra patriotëve të Gollobordës si Medin Kormaku, Hoxhë Hazis Lila, Hoxhë Hasan Moglica,

Pikërisht në këtë kohë kemi daljen në skenë të dhjetra patriotëve të Gollobordës si Medin Kormaku, Hoxhë Hazis Lila, Hoxhë Hasan Moglica, Imer Hoxha, Kadri Fejza, Zenel Kormaku, Feta dhe Dan Cami, Elez Koçi dhe shumë të tjerë. Ata intensifikuan lidhjet me Aqif Pashë Elbasanin (Biçakun) dhe nëpërmjet tij me Ismail Qemal Vlorën

Imer Hoxha, Kadri Fejza, Zenel Kormaku, Feta dhe Dan Cami, Elez Koçi dhe shumë të tjerë. Ata intensifikuan lidhjet me Aqif Pashë Elbasanin



(Biçakun) dhe nëpërmjet tij me Ismail Qemal Vlorën.

Medin Kormaku nuk arriti që ta shohë Shqipërinë të pavaruar, por ai ishte pararendësi

i pavarësisë së Shqipërisë.

(Marrë me disa shkurtime nga libri: "Stebleva, histori dhe figura" të studiuesit Ramazan Hoxha.

MJESHTRI I NDËRTIMIT XHAFER ÇELA, HERO I PUNËS DHE SHPIRT I NJERIUT

(Homazh pas vdekjes)

Xhafer Çela ishte nga ata njerëz të devotshëm që luftuan për ta çuar përpara ëndrrën e heronjve të luftës për të pasur një Shqipëri të lumtur e të bukur.

Si homazh dhe si kujtim për ne ishte nderi dhe respekti një shumice njerzish që muarën pjesë në dhënien e lamtumirës së fundit ditën që u nda nga jeta mjeshtri i ndërtimit dhe heroi i punës socialiste Xhafer Çela, njeriu që për dyzet vjet nuk ju nda profesionit të muratorit, njeriu që jetoi me çekiç në dorë dhe me ëndërra në sy.

Ai ishte gojë ëmbël me të gjithë, i vëmendshëm me të moshuarit dhe kërkues ndaj të rinjve e fëmijëve të tij, kërkues edhe ndaj nesh që e shoqëronim e jetonim me te. Ai trajtonte me seriozitet çdo problem që i shtronte për zgjidhje, po me atë lehtësi që kryente edhe mjeshtërinë e muratorit.

Sot kur nuk jeton është krenari të shkruash për këtë figurë të pastërt si qelbari. Është më se e natyrshme që ndarja e tij nga jeta ka lënë një zbrastësi të madhe në zemrat e gjithë atyre që e kanë njohur mirë këtë hero të punës që ka dalë nga gjiri ynë.

Xhafer Çela, ose Xhafa, siç e thirrnim në të gjithë ka lindur në fshatin Sebisht të rrethit të Dibrës në vitin 1933. Në moshën 15 vjeçare ai largohet nga fshati i lindjes bashkë me babain, nënën dhe motrat e tij, ku u vendos përfundimisht këtu në Tiranë. Në fillim ai punoi si hysmeqar në një familje të

pasur.

Me vonë me kalimin e kohës filloj punë në ish ndërmarrjen e ndërtimit 21 dhjetori deri në mbylljen e plotë të saj në fillim të proceseve demokratike.

Ai me brigadën që drejtonte mori pjesë në veprat kryesore që në ato vite ndërtoheshin në Tiranë si në ndërtimin e spitalit civil, sot spitali "Nënë Tereza", në ndërtimin e Muzeut Historik Kombëtar, në ndërtimin e piramidës, në ndërtimin e ish pallatit të kulturës etj.

Për punë të pa lodhur dhe për zbatimin me cilësi të projekteve që i besoheshin ai u dekorua disa herë si mjeshtër ndërtimi deri sa mori dhe titullin hero i punës.

Në bisedat e lira që ne bënim Xhafa shpesh do na tregonte se si në fillim nuk e kish të dashur punën e muratorit pa vërsisht se nga krahina e tij kishte plot njerëz që e përqafojnë këtë zanat. Nuk e kuptoj, shprehej ai, se me kalimin e kohës, shumë shpejt ky profesion më tërhoqi. Sa sot edhe në gjumë ëndrojmë se çfarë mund të nxjerr nga duart e mia, në ditët e ardhshme, në zbatimin konkret të projekteve që na japin për zbatim artitektët duartat, që megjithëse në kushte të vështira shkëlqenin si profesionistë. Dëshirën për këtë zanat mundoheshja për t'jua ngulitur të rinjve puntorë që kisha në brigadë. Si i tillë edhe përse isha i rritur në moshë, shpesh shkoja në mbledhjet e ish organizatave të rinisë.

Një i ri që kishte punuar vite më parë në brigadën e Xhafës ditën e dhënies së lamtumirës së fundit, u shpreh se në të rinjtë ate nuk e kishim vetëm si brigadier, por edhe si prind. Me këshillat e urta të tij na bente të ishim edhe më të përgjegjshëm në shfrytëzimin e kohës së punës dhe rritjen e cilësisë së ndërtimit. Ai edhe na toleronte në rastet kur gabonim, por ne edhe e kishim kuptuar, se shkallën e tolerancës e kish të aq sa ja lejonte vetë ndërgjegjja e tij. Ai e çmonte kohën e punës në maksimum, në çdo rast na porosiste, që ne ndërtoesit, çdo ditë të punës duhet ta kthejmë në vepra ndërtimi. Edhe për Xhafën të gjitha ata që e kanë njohur kujtojnë sot me mall se si nga fytyra e tij burrërore buronte mjalhtë njerzor. Duke patur të gjitha këto cilësi, që në pamje të parë, të jepte përshtypjen e një njeriu që dinte të bënte për vete. Të gjithë e donim dhe e respektonim, tregojnë shokët e tij të punës Zylifi, Samiu, Muhameti, Vlasi, Rustemi etj.

Ndësa Hamdia, bashkshortja e tij, shprehet se ai siç ishte një shok i mirë me njerzit me të cilët punonte, ishte edhe një bashkeshortë prind i mrekullshëm. Edhe tani më kumbon në vesh zëri i tij i ëmbël që kam pasur fatin për të më shoqëruar në një jetë të tërë. Ai dinte që nga goja e tij të nxirte vetëm fjalë të mira, fjalë që kishin peshë në edukimin e fëmijëve që rritëm së bashku si Shaqirin, Ilirin, Florinën, Yllkën, Verën e Fatbardhën, që të gjashtë, njeri më

Ai me brigadën që drejtonte mori pjesë në veprat kryesore që në ato vite ndërtoheshin në Tiranë si në ndërtimin e spitalit civil, sot spitali "Nënë Tereza", në ndërtimin e Muzeut Historik Kombëtar, në ndërtimin e piramidës, në ndërtimin e ish pallatit të kulturës etj.



i mirë se tjetri, të cilët që të gjithë kanë krijuar familjet e tyre. Unë kam pasur fatin që për bashkshort të kisha një njeri si Xhafa, i cili sot është i pa vdekshëm për të gjithë ata, që e kanë njohur. Më kuptim plote po na duket tani shprehja popullore se mençuria e njeriut shkëlqen edhe pas vdekjes.

Ai sot është i ndarë nga ne, por mësimet që na ka dhënë janë të ngulitura në mendjet e fëmijëve, motrave, nipërve e mbesave që e rrethonin e që i donte dhe e donin shumë. Mësoni dhe mos e harroni të kaluarën, na porosiste, vështroni me kujdes ku keni arritur dhe nxirni detyra për të ardhmen, se vetëm kështu do të bëheni dikush, veçanërisht sot kur demokracia ju ka hapur rrugë për të përparuar.

Tregonte me admirim vilat e bukura të ndërtuara aty

në rrugën "Riza Cerova", në një lagje të vjetër të Tiranës, ku ai ka jetuar për vite të tëra.

-E shikon më thoshte se çfarë vilash janë ndërtuar, njera më e bukur se tjetra. -Ju lumtë, tani në demokraci, ku vlera e individit shprehet në zotësin e sejcilit shohim se shqiptarët po e tregojnë akoma më shumë se kanë qenë dhe janë punëtorë të pa lodhur aq sa janë dhe mikpritës e bujar.

Njerzit si Xhafa janë persona që fshiheshin midis nesh duke qëndruar në heshtje. Madhështia e tyre zë e lartësohet në pedistalet e saj kur nuk i kemi midis nesh. Dihet se natyra e ka ligj të saj se kush ka rënë në djep do të bie edhe në varr, por e rëndësishme mbetet për njeriun që vepra ose puna e tyre të mos harrohet.

HASAN MIHA

ADEM KORMAKU

Si e ndërtuam pesëmbëdhjetëkatëshin e parë në Shqipëri dhe monumentin e Mat'hauzenit në Austri

Jam krenar që jam lindur në Steblevë. Nga Stebleva kam kujtime të paharruara të fëmijërisë. U rrita në një familje të varfër. Babai, Hamit Musa Kormaku vdiq në vitin 1942 duke e lënë nënën time me gjashtë fëmijë në mes të hallevë. Unë, fëmija më i vogël isha vetëm gjashtë muajsh. Na rriti nëna me njëmijë mundime, por na rriti të shëndetshëm, njërin më të fortë se tjetri.

Shkollën fillore e mbarova në fshatin e lindjes me mësues Gani Kormakun në vitin 1952. Meqenëse mbarova me rezultate të shkëlqyera mësues Ganiu i kërkoi nënës që të më dërgonte në Peshkopë, në konvikt, për të ndjekur shkollën 7 vjeçare. Nëna kishte frikë që të më largonte nga shtëpia sepse më kishte rritur me njëmijë halle. Në atë kohë shkuan në Peshkopë për të ndjekur shkollën Fanije Hoxha dhe Fadil Shabani.

Unë ndenja pranë nënës dhe e ndihmoja atë. Ndërsa vëllezërit e mi Haliti,

Abibi dhe Xhevahiri punuan si punëtorë hyzmeqarë në Elbasan dhe më vonë si punëtor ndërtimi në Tiranë dhe në qytete të tjera.

Në vitin 1957 kam bërë udhëtimin e parë për në Tiranë me Haxhi Gaxhën. Natën e parë fjetëm në Elbasan, ndërsa ditën tjetër udhëtuam për në Tiranë ku na prisnin Haliti dhe

Xhevahiri të cilët punonin në ndërtim. Ishte hera e parë që prekja ëndrrën time, Tiranën.

Asnjëherë nuk më mungoi dëshira për të vazhduar sh-



dhënë koncert me Orkestrën Frymore.

Në vitin 1961, pas lirit nga ushtria punova në ndërtimin e Pallatit të Kulturës në Tiranë.

Ndërkohë ndoqa Teknikimin e ndërtimit pa shkëputje nga puna. Gjatë punës si brigadier dhe përgjegjës ndërtimi mu vlerësua puna për aftësitë organizative dhe profesionale.

Në vitin 1968 mora titullin Asistent inxhinjer ndërtimi dhe u emërova përgjegjës sektori në Ndërmarrjen 21 dhjetori.

Nga viti 1968-1970 ndoqa kursin 2 vjeçar të inxhinjerisë së ndërtimit në Universitetin e Tiranës dhe pas këtij kursi emërohem drejtor kantjeri në Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit. Kantieri ynë i Tiranës ndërtoi Uzinën e Petëzimit të çelikut dhe atë të

gizës.

Nga viti 1972-1976 shërbej si drejtor kantjeri ndërtimi në objekte shumë të rëndësishme si Hotel 15 katëshi, Hotel Arbëria, Galeria e Arteve Figurative, Hotel Arbana, Ministria e Jashtme si shumë shkolla të Tiranës.

Nga viti 1976-1983 shërbej si drejtor ndërmarrjeje për ndërtime të veçanta strategjike të rëndësishme së veçantë që vareshin dhe kontrolloheshin nga shumë digastere me rëndësi të vendit.



Si e ndërtuam monumentin e Mat'hauzenit në Austri

Sigurisht ditët më të paharruara për mua kanë qenë ditët për ndërtimin e monumentit të Mat'hauzenit. Me 24 shtator 1968 së bashku me dy shokët e mi Llazar Maznikun nga Vërnica dhe Taqo Mihon nga Korça, së bashku me tre mjete me rimorkio të ngarkuara me materiale ndërtimi udhëtuam në itinerarin Tiranë-Strugë-Shkup-Prishtinë, Beograd, Zagreb, Maribor, Austri. Në Beograd, në ambasadën tonë, na priti bashkëfshatari im nga Stebleva

Hajrulla Kuburi. Morëm viza për në Austri dhe vazhduam për në Zagreb e Maribor.

U futëm në Grac dhe më pas në mallet e Semeringut dhe në orën tre të mëngjezit arritëm në Vienë. Për verifikim materiale dogana e Vienës na mbajti tre ditë në Vienë, ku shëtitem shumë dhe gjatë në këtë qytet të bukur të Austrisë dhe të Europës. Dëborë e parë në Austri na zuri me 15 nëntor. Për ndërtimin e monumentit punuam deri më 27 nëntor të vitit 1968, ditë që edhe u përrua.



Një ikonë e arsimit shqiptar

(Vlersime për librin
"Sheshet e betejave të
Skënderbeut në dritën e realitetit")




Ne vazhden e librave per Golloborden, prej figurash tashme te njohur ne fushen e letrave, libri "Sheshet e betejave te Skenderbeut ne drite te realitetit" me autor Vahid Kormaku, pa dyshim ze nje vend te rendesishem ne fondin e arte te kultures shqiptare. Vahid Kormaku tashme rilind ne memorien e brezave ne Stebleve, Diber e me gjere.

Stebleva eshte nje fshat me tradita patriotike, kulturore e historike. Eshte i vendosur ne

reflektojne ne studimet e tij per probleme te historise, gjeografise e botanikes ne zone. Eshte autori i pare i studimeve rreth luftrave te Skenderbeut ne trevat e Gollbordes. Argumentat mbi kalane e Mecadit, Orvenikut, Modricit, Koxhaxhikut (Sfeti-gradit) e fushe-betejat ne Torvioll, kullat e rruge kalimet e ushtrise se Skenderbeut grykave te Drinit te Zi e te Radikes, qe nga Pollogu e deri ne Kruje, perbejne nje ndihmese te cmuar ne historiografinë shqiptare.

Ja cfare shkruan ne kujtimet e tij studiuesi gjerman, Von Dr. Friedrih Markraf ketu e 95 vite me pare, mysafir e bashkepuntor i Vahidit: "Ne hyrje te Stebleves gjetem burra te zene me nderimin e shtepive. Serbet ua kishin djegur fshatin... Ne shtepine e Va-



gryka malesh, mbrojtur prej stuhish e prej hasmit, fale trimerise e udheheqesve te sprovuar si: Islam Lama, Hazis Lila, Ajdin Gruja, Adem Bojaxhiu, se bashku me qindra luftetare e gra trime si: Xhemile e Rabije Abazi, Nesla Shabani, Hatixhe Kormaku, Mejte Disha e Zylfije Murati, te cilet e shkruan me gjak historine e Stebleves ne vitet 1912-1920 ne luften me serbet:

...Plasi pushka, gjemon toka,
Kujtoi Xhema se erdh Evropa,
Keto vende jane me huqe,
Kesulen ta bejne te kuqe.

Ne vazhden e ketyre traditave u rrit dhe u afirmua intelektual i shquar, shkencetari eurodit, Vahid Kormaku. Ai lindi me 17.06.1894. Mesimet e para i mori ne mejtepin turk te fshatit, pastaj ne Selanik dhe studimet e larta i perfundoi ne Stamboll. Ai u be nje intelektual me njohuri te gjera, qe do te

hidit une ngela i befasuar nga nje tufe lulesh, dicka e pazakonte ne kuptimin e dobise se tyre. Diten tjetër u ngjitem deri te Gropa e kuqe (Cerveni Kutell). Emrat e luleve i mesova nga mesuesi... Nje det me gonxhe shumengjyreshe te kuqe, roze, te verdha, te bardha, zymbyla blu e shume lule te tjera. Aty qe fundi i perallave qe te dehin... U ndava me 14 qershor duke fituar ne zemer nje ithtar te botanikes."

Punen si mesues e filloi ne vitin 1921 ne Tunje te Suloves - Gramsh. Dhe shkolla, deri vone, mbajti emrin e tij "Vahit Stebleva". Ndhimese dha ne hapjen e shkollave shqipe ne zone. Me 1923 hapet shkolla shqipe ne Borove me mesues Vahid Kormaku. Ne mars 1927 hapet shkolla shqipe ne Stebleve me mesues Vahit Kormaku. E me pas do te punoje ne Klenje, ne Ostren te Madh, ne Zerqan e ne Bulqize. Vdekja

VAHID KORMAKU

SHESHET E BETEJAVE TË SKËNDERBEUT NË DRITË TË REALITETIT

e mori ne kulmin e jetes e te prodhimtarise intelektuale. U varos me nderimet me te medha nga miqte e bashkefshataret e tij ne varrezat e Bamit ne Tirane, me 26.12.1946.

Jeta dhe vepra e tij prej nje intelektual te kompletuar, mbeti nje model per qindra intelektuale te Gollobordes e me gjere. Ai ishte nje Naim apo nje Kristoforidh, thuaq si te duash, per ate zone. Ishte ora 7 e mengjesit i vitit 1986, sapo behsha gati te nisem per ne Klenje, kur Radio-Tirana ne rubriken: "Kalendari historik" perkujtonte 40 vjetorin e vdekjes te ketij Akademiku te pashpallur dhe dokumentat e arshivuar prane Akademise se Shkencave ne Tirane. Ai mbeti nje studiues i respektuar dhe mik i ngushte i Prof. Aleks Buda. Me librin "Sheshet e betejave te Sk-

enderbeut ne driten e realitetit" te autorit, Vahid Kormaku, "Gollobordasit e Dibres" te autorit Hilmi Sadiku dhe studiuesit per Lufttrat e Skenderbeut, Sinani, celnikose

perfundimisht vzhdimsia iliroshqiptare e treves se Gollobordes. Kam patur fatin e mire qe, per kontributin e Vahid Kormakut, me gjere te flase ne vitin 1984, ne sesionin shkencor ne Trebisht me rastin e 70 vjetorit te shkolles pare shqipe, ne kumesen "Lufta per gjuhen dhe kulturen shqipe ka qene e pandare nga lufta per identitet kombetar", pastaj ne vitin 1986, ne sesionin shkencor me rastin e 60 vjetorit te shkolles shqipe ne Klenje dhe ne librat "Veshtrim ne vite" fq.50-51. Dhe "Mesazhe jete" fq.16-17. Merite ka edhe autori i "Enciklopedise se Dibres" z. Fatos

Daci qe e ka trajtuar me se miri.

Emrin e tij e kane nderuar dhe vazhdojne ta nderojne intelektuale te tjere nga familja e tij si: Gani Kormaku, Teuta Kormaku, Abduraman Kormaku, Bardhyl e Shpetim Kormaku, Vahit Kormaku i Riu, Hajrie Kormaku, Shkendije Kormaku, Isak Kormaku.

Edhe pse po kalon nje shekull, emri e vepra e tij nderohet nga niperit e brezi i ri i Stebleves. Merite te vecante per botimin e ketij libri ka nipi i tij Vahid Kormaku, duke e ringjallur para lexuesit shqiptar. Per ne eshte krenari qe te perulemi me veneracion para kesaj ikone te kultures shqiptare.

Mehmet Hasani
Zv.Kryetar i Unionit te
Krijuesve Dibrane.
Tiranë, me 14. 03.2012.

SKULPTORI HAMZA HALILI

Artisti që e bën gurin dhe drurin të buzëqeshë dhe të qajë si njerëzit

Ka shumë artistë që mbeten të panjohur për faktin se punët e tyre i kanë përvetsuar të tjerët dhe janë mburrur me to. Kanë mbetur në hije sepse si edhe në disa fusha të tjera të jetës edhe në letërsi, art dhe muzikë disa të vetëquajtur të mëdhenj vazhdojnë të trumbetohen si të pazëvendësueshëm, si gjenialë, si ata nuk paska të tjerë.

Një nga ata artistë që të magjeps me punët e tij dhe që nuk mburret për to është skulptori Hamza Halili.

Po kush është Hamza Halili ?

Lindi në Trebisht të Dibrës më 13 maj 1939. Me mbarimin e shkollës së mesme artistike u vendos në Tiranë ku dhe vazhdon të banojë. Ka shërbyer si specialist për shumë vite në Ndërmarrjen Artistike "Migjeni" Tiranë si dhe në Shkollën e Mesme Artistike "Jordan Misja".

Është autor i qindra punimeve artistike në dru allçi, gurë dhe në mermer. Më 1963 mori pjesë për herë të parë në Ekspozitën Kombëtare të Arteve Figurative në Tiranë me portretin në allçi "Fëmija", një punim që tërhoqi vëmendjen e kritikës për shijën e hollë të dhe talentin e autorit. Që atëherë është pjesëmarrës i rregullt në të gjitha ekspozitat kombëtare që janë hapur në Tiranë. Më 1990 hapi në Tiranë ekspozitën e parë vetjake dhe më 1996 ekspozitën e dytë.

Skulptori dhe piktori Hamza Halili ka marrë pjesë në grupet e punës për realizimin e shumë veprave madhore të arteve figurative si të monumentit "Nënë Shqipëri", në Tiranë, të monumentit të Pavarësisë në Vlorë etj.

Ndër punimet më të njohura dhe të vlerësuara janë portreti në allçi "Heroi i urave" 1969, kompozimet në dru "Hedhja e farës" 1970, "Fillad rinor" 2005, "Perla e jetës" 2005 etj.

Mjaft nga punimet e skulptorit Hamza Halili kanë zënë vend në galerinë e arteve, në institucione të ndryshme artistike dhe në koleksione të shumta brenda e jashtë vendit si në Itali, Gjermani, Greqi, Maqedoni etj.

Pas një pune 15 vjeçare në studio dhe disa dekadave në veprimtari në dobi të prodhimit ai vendos të dalë me një ekspozitë me punime të zgjedhura. Në sallën "Ibrahim Kodra" në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë, dhe Sporteve u ekspozuan 46 punime të tij, kryesisht në dru, allçi, gur dhe mermer. Këto punime janë të kohëve të fundit, por ka edhe ndonjë peng të vjetër të artistit, të paraviteve 90, që nuk mundi



ta ekspozonte në atë kohë, për vetë kohën që ishte. Bie në sy, talenti, individualiteti artistik, mjeshtëria e skalitjes e trashëguar nga ustallarët e Dibrës dhe të Gollobordës që e bëjnë drurin të qeshë dhe gurin të flasë. Më parë ka marrë pjesë së bashku me të tjerët në ekspozita të ndryshme në Galerinë e Arteve Figurative, por tani ka "pushtuar" sallën që mban emrin e të madhit Ibrahim Kodra.

Skulpturat e tij nuk kanë diçitura. Çdokush i shikon, interpreton dhe përjeton sipas perceptimit të tij. Dhe kjo është dëshira ime artistike, shprehet skulptori.

Në këto skulptura ka realizëm, por ka edhe abstraksion,

por ka edhe novatorizëm. Pjesën më të madhe të tyre e kanë figurat kombëtare si Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Adem Jashari, Naim Frashëri, artistja e madhe Tefta Tashko Koço etj. Bie në sy kushtimi që i bën autori figurës së femrës shqiptare, të nënave. Do të shohësh edhe një grua të ngarkuar me bucelën e ujit, edhe një nënë që ushqen fëmijën me gjirin e saj, edhe një vajzë që është veshur me rroba plazhi. Janë femra të lindura nga druri, nga guri, i them me dashamirësi skulptorit. Figura e femrës dhe e nënës në tërësi është parë në kompleksitetin e vet, por edhe si krijuese të jetës. Një skulpturë që paraqet një grua të ngarkuar, që mban në shpinë

Pas një pune 15 vjeçare në studio dhe disa dekadave në veprimtari në dobi të prodhimit ai vendos të dalë me një ekspozitë me punime të zgjedhura. Në sallën "Ibrahim Kodra" në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë, dhe Sporteve u ekspozuan 46 punime të tij, kryesisht në dru, allçi, gur dhe mermer. Këto punime janë të kohëve të fundit, por ka edhe ndonjë peng të vjetër të artistit, të paraviteve 90, që nuk mundi ta ekspozonte në atë kohë, për vetë kohën që ishte

ngarkesa, dru, apo bar për bagëtinë, të duket si fenomen i së shkuarës, por është edhe sot një realitet i hidhur si dikur. Ka akoma gra në zonat rurale që ngarkohen me peshë të rënda dhe kjo duhet të na shqetë-

nuk mburret. Talenti i lindur, ndonëse vetëm me shkollën e mesme artistike, sepse nuk e dërguan në Akademinë e Arteve bënte të mundur që gjërat e dala nga Hamzai të ishin të gjalla si njerëzit.



sojë të gjithë, jo vetëm autorin. Skulptori Halili, më thotë se kjo i përket së shkuarës në zonat e vendlindjes së tij, por unë e kundërshtoj se fatkeqësisht ky fenomen ndodh përsëri. Burrat janë në kurbet dhe gruas i bien të gjitha punët e rënda të sh-tëpisë.

Skulptori Halili i kushtohet edhe temës së mërgimit. Gollobordasit kanë qenë mërgimtarë brenda vendit të tyre edhe para viteve 90. Ata i ndërtuan pothuajse të gjitha veprat më të mira të paraviteve 90. Autori paraqet një kërcu të gdhendur artistikisht, një zgavër të thellë që nuk mbushet, që shpreh një grua që prët, prët pafundësisht, burrin, djalin, vëllain të vijë nga kurbeti. Ngjarjet e Otrantos, mbytja e dhjetra shqiptarëve në detin e trazuar e ka shqetësuar autorin dhe e ka shprehur në skulpturat e tij që janë portrete që flasin, që akuzojnë. Po kë ?!

Kur mëson që autori ka punuar në Ndërmarrjen Artistike "Jordan Misja" dhe se nga mendja dhe duart e tij kanë dalë qindra projekte e modele artistike habitesh me thjeshtësinë e tij dhe qetësinë e tij. Ai

Hamzait i pëlqen të përgatisë vepra skulpturore që vendosen në parqe ashtu si në disa vende të Europës dhe të botës. Ai filloi të pikturojë dhe të përgatisë skulptura që në moshën 17-18 vjeçare kur ishte nxënës në liceun artistik. Që në vitin 1964 ai ekspozoi skulpturën e parë të titulluar "Portret fëmije, skulpturë që u vlerësua maksimalisht nga skulptori Andrea Mano, i cili do ta merrte Hamzain kudo ku ai punonte në komplekset skulpturore monumentale të vendit. Kështu Hamzai merr pjesë në përgatitjen e veprës "Nënë Shqipëri", të monumentit të pavarësisë në Vlorë, në Gjirokastër etj. Ai nuk e nxjer nga duart veprën pa e latuar deri në perfeksion, deri sa ta shëndrojë në një qenie të gjallë. Jeta e gjallë në krijimtarinë e tij është tipari kryesor që e shfaqëron atë. Mjeshtëria artistike, individualiteti, mbështetja në tabanin kombëtar janë pjesët përbërëse të krijimtarisë të këtij artisti të heshtur, por që meriton vëmendje.

Sakip Cami,
Poet dhe publicist



Ç'PO NA DJEG MALLI, O PERPARIM PIRUSHI!



ne, ate te 17 dhjetorit 2001.

Per steblevasin cdo humbje njerezore eshte pjese e shpirtit te vet pa dallim feja e hierarkie kulture. Dhimbja per ju i kaloi kufijte e Stebleves e mori permasa te krahines, te Dibres e te Tiranës, ku punove e jetove duke u afirmuar si intelektual i devotshem, si fizikant me emer, si drejtues i zoti e ne krenoheshim me Ju. Jeta juaj ka qene e shkurter, por ka qene me vlera te medha ne fushen e arsimit.

Ne u rritem se bashku ne ato rruge, ne ato lagje, ne ato pllaja e male plot pyje e aroma lulesh te Stebleves.

A nuk luanim e mesonim se bashku? A nuk shkonim ne ato rudina se bashku? Po skite nuk i benim se bashku e nuk linim pllaje ne Vollnisht pa kapercyer? Sa i doje dhe te donin shoket e klases: Qazim Baushi, Fatmir Gaxha, Dilaver Abazi, Kadri Kurti, Lulzim Murati, Ibrahim Murati, Arif Mysliu, Hekuran Muca, Fuat Gjerani, Enver Murati, Mersim Hoxha, Demir Murati, Agim Nura, Hekri Disha, Mirvete Gjini, Fatbardha Nura, Ibrime Avdiu, Anife Agushi, Remzije Murati, Fiqrete Lila, Hambije Disha, Stojke Cfarku, Fatime

Kurti, Kimete Fejza, Rafe Cfarku.

A nuk i kujtonim me respekt mesuesit tane qe na mesuan me perkushtim: Rexhep Despoti, Mehmet Hasani, Zilatan Karaxha, Emin Rada, Velo Milloshi, me drejtorin tone te respektuar, Ferit Uliu?

Ne ishim klase e mire dhe s'ngeli njeri pa mbaruar arsimin e mesem, madje disa edhe shkollat e larta. Ju vazhduat gjimnazin ne Lac e pastaj Fakultetin e Shkencave te Natyres, dega fizike ne Tirane dhe e mbaruat shkelqyeshem. Filluat punen si mesues fizike ne shkollen e mesme te Klenjes, pastaj ne gjimnazin ne Peshkopi, prej aty ne shkollen e mesme ne Baldushk dhe prej vitit 1991 deri ne vitin 2001, drejtor i sholles se mesme Kamez ne Tirane.

Ne si shoke gezoheshim per aftesite tuaja, per shpirtin tuaj human, per thjeshtesine tuaj. Kurdohere ju manifestuat cilesite me te mira te respektit, mirenjohjes, tolerances, solidaritetit njerezor, aftesine e padiskutueshme si drejtor, mbi



te gjitha pergatitjen e larte shkencore si fizikant. Per te gjitha keto ngele nje pishtar i pashuar ne Obeliskun e arsimit shqiptar.

Ne do te vazhdojme te te kujtojme duke te mbajtur ne zemer per sa te jemi gjalle, ndersa brezat do te perulen me respekt para figures tuej te nderuar....

*"Po kur te jsh merzitur shume
Ne raft te librave kerkome,
Atje do jem fshetur une,
Ne ndonje varg a ne ndonje
shkronje."*

Le te jete ky kujtim nje homazh per jeten tuaj dhe nje kujtese per drejtuesit lokale ne Stebleve, qe ne ndonje eveniment tu japin vleresimin e merituar si bir i denje i Stebleves, atij fshati me tradita te shquara patriotike e kulturore.

**Mirenjohje nga shoket e klases VII-1970:
Ibrime Avdiu, Lulzim Murati, Mersim Hoxha, Demir Murati, Dilaver Abazi**

FOTOREPORTAZH: STEBLEVA NË STINËN E DIMRIT, PËRGATITJA PËR KAMPIONATIN E SKIVE DHE TË ALPINIZMIT



Në foto: Trajneri i ekipit të skive dhe alpinizmit, kryetari i komunës Alban Fejza, Kryetari i Shoqatës "Stebleva" Mersin Hoxha dhe Arben Hoxha

Adresa e redakisë: Rruga "Xhon Belushi" Mbas Institutit të Fizikës Bërthamore, Vila Nr 519, Tiranë. Tel. 0695168173.

